



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/186
Datë: 29.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116 dhe Ligjin Nr. 04/L-194, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitet 2015-2017.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Kornizën nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/186
Datë: 29.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) si dhe nenit 145 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës zotohet që të marrë përsipër borxhet e mundshme nga marrëveshjet e vjetra në mes të ish Federatës Jugosllave dhe Qeverisë Japoneze të cilat janë realizuar në territorin e Kosovës, dhe do të kryej obligimet për to pasi të arrihet Marrëveshja e suksesionit në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.
2. Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, do të komunikojë me Qeverinë Japoneze për të informuar lidhur me këtë zotim të Qeverisë.
3. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/186
Datë: 29.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës do të iniciojë ndryshimin e politikave të saj lidhur me tatimin doganor me qëllim të ofrimit të lehtësirave tatimore për bizneset prodhuese në Republikën e Kosovës.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes Ministrisë së Financave do të fillojë të bëjë analizat e duhura me qëllim të plotësimit të anekseve të Ligjit Nr. 04/L-163, për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, me qëllim të ofrimit të lirimeve edhe për mallrat tjera të cilat përdoren si lëndë e parë nga bizneset në Republikën e Kosovës.
3. Ministria e Financave, pas analizave dhe pas konsultimit me përfaqësuesit e sektorit të biznesit të propozojë udhëzimin administrativ me të cilin do të propozohen lirimet e tilla.
4. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/186
Datë: 29.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës do të iniciojë ndryshimin e politikave të saj tatimore me qëllim të ofrimit të lehtësirave tatimore për investimet e reja si në vazhdim:
 - 1.1 Për investimet e reja mbi 10 milion €, me së paku 150 vende të reja pune e lidhur me shumën e investimeve, do të ketë norma tatimore prej 0 % nga norma standarde e tatimit në të ardhurat e korporatave e cila do të aplikohet për 7 vite, dhe norma 0% e tatimit mbi vlerën e shtuar e cila do të aplikohet për investime në kapacitetet prodhuese.
 - 1.2 Për investimet e reja deri 10 milion €, me së paku 100 vende të reja pune e lidhur me shumën e investimeve, do të ketë norma tatimore prej 0 % nga norma standarde e tatimit në të ardhurat e korporatave e cila do të aplikohet për 5 vite, dhe norma 0% e tatimit mbi vlerën e shtuar e cila do të aplikohet për investime në kapacitetet prodhuese.
 - 1.3 Për investimet e reja prej 2 - 5 milion €, me së paku 50 vende të reja pune e lidhur me shumën e investimeve, do të ketë norma tatimore prej 0 % nga norma standarde e tatimit në të ardhurat e korporatave e cila do të aplikohet për 3 vite, dhe norma 0% e tatimit mbi vlerën e shtuar e cila do të aplikohet për investime në kapacitetet prodhuese.

- 1.4 Për investimet e reja deri 2 milion €, me së paku 30 vende të reja pune e lidhur me shumën e investimeve, do të ketë norma tatimore prej 0 % nga norma standarde e tatimit në të ardhurat e korporatave e cila do të aplikohet për 1 vit, dhe norma 0% e tatimit mbi vlerën e shtuar e cila do të aplikohet për investime në kapacitetet prodhuese.
2. Obligohet Ministria e Financave që të hartojë plotësimin dhe ndryshimin e legjislacionit tatimor me qëllim të ofrimit të lehtësirave tatimore për investimet e reja dhe krijimin e vendeve të reja të punës.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa fillon të zbatohet pas ndryshimit të legjislacionit përkatës tatimor.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/186
Datë: 29.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren nr. 08/2012 për nëpunësit civilë tepricë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2014, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 15/26 të datës 27 korrik 2011

1. Pika 1. e vendimit të Qeverisë nr. 15/26 të datës 27 korrik 2011 zëvendësohet me tekstin si në vijim: "z. Valdrin Lluka, emërohet Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve"
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/186
Datë: 29.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Planit Nacional i Veprimit për vitet 2014-2016 në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur - PQH.
2. Buxheti për zbatimin e Planit Nacional të Veprimit për vitet 2014-2016 Partneriteti për Qeverisje të Hapur, duhet të mbetet brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për vitet 2014-2016 dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera përgjegjëse sipas Planit Nacional të Veprimit.
4. Ministria e Integritimit Evropian obligohet për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit Nacional të Veprimit për vitet 2014-2016.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/186
Datë: 29.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për përgjimin e komunikimeve elektronike.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/186
Datë: 29.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 19, paragrafi 3.3 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës 17 dhjetor 2010, me referencë AGJ 75/10, në Rastin nr. I 08/09, Vendimit Nr.04-V-799 të Kuvendit të Republikës së Kosovës të datës 19 mars 2014, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në përputhje me vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.04-V-799 të datës 19 mars 2014, heq dorë nga pranimi i mjeteve tepricë sipas nenit 19, Paragrafi 3.3 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimi, në shumën në të cilën AKP-ja do të përmbush detyrimet ndaj punonjësve të Fabrikës së Gypave të Çelikut - IMK Ferizaj sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës i datës 17 dhjetor 2010, me referencë AGJ 75/10, në Rastin nr. I 08/09 të punonjësve të Fabrikës së Gypave të Çelikut - IMK Ferizaj, në pikën 3 përcakton se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit janë përgjegjëse për zbatimin e vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj në rastin konkret.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes vendimit Nr.04-V-799 të datës 19 mars 2014 në pikën 1, e obligon Agjencinë Kosovare të Privatizimit të sigurojë pagesën e borxhit ndaj punëtorëve të fabrikës së Gypave të Çelikut në Ferizaj, ndërsa në pikën 2 e obligon Qeverinë që konform bazës ligjore dhe kompetencave të saj të kryej të gjitha obligimet e saj.

4. Në përputhje me nenin 19, paragrafi 3.3 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Agjencia përcakton dhe deklaron si "Fonde Tepricë" deri në shtatëdhjetë e pesë përqind (75%) të çdo të ardhure që e tejkalon maksimumin e vlerës së përlogaritur të grumbulluar të pretendimeve përkatëse të kreditorit dhe interesave të pohuara të pronësisë, dhe menjëherë i transferon ato Fonde Tepricë "para publike" dhe trajtohen në pajtim me LMFP të cilat do të shfrytëzohen për zhvillimin ekonomik të vendit, me aprovim të Kuvendit të Kosovës.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Agjencisë Kosovare të Privatizimit



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/186
Datë: 29.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për transferin e mjeteve në shumë prej 2,100,00.00 € nga kategoria ekonomike investime kapitale në kategorinë ekonomike subvencioneve dhe transfere brenda programit Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë